



KMDK SH.A	Datë <input type="checkbox"/>
	Hyrëse <input type="checkbox"/>
Nr: 553/2017	
Data: 31.07.2017	
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A Kosovo Landfill Management Company J.S.C Kompanija za Upravljanje Deponijama na Kosovu J.S.C	

Në bazë të nenit 20 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 138 të Ligjit Nr. 02-L-123 për Shoqëritë Tregtare, në bazë të nenit 76 të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, në bazë të nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 7 të Statutit të Kompanisë, Bordi i Drejtorëve të KMDK SH.A, miraton Rregulloren si më poshtë:

RREGULLORE NR. 06/2017 PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË DEPONITË SANITARE TË KOMPANISË PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A

KAPITULLI I QËLLIMI, OBJEKTI DHE FUSHA E VEPRIMIT

Neni 1

- 1) Kjo rregullore përcakton organizimin e punës, kushtet dhe mënyrën e trajtimit/deponimit të mbeturinave komunale/sanitare në të gjitha deponitë regjionale me të cilat menaxhon "Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A " dhe ka për qëllim parandalimin, shmangien/evitimin dhe zvogëlimin e ndikimeve negative në ndotjen e mjedisit dhe ruajtjen e shëndetit të njeriut.
- 2) Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës SH.A.(në tekstin e mëtejme KMDK SH.A.), është pronare e vetme dhe operatore legale e Deponive Sanitare të Mbeturinave në Kosovë e cila shërben në regjionet e Prishtinës, Gjilanit, Prizrenit, Podujevës, dhe të Ferizajit.
- 3) KMDK SH.A. është e regjistruar në Agjencionin e Regjistrimit të Bizneseve në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, selia e Drejtorisë së Kompanisë është në Prishtinë, ndërsa operon dhe menaxhon me këto deponi:
 1. Deponia Sanitare regjionale - Prishtinë (Mirash)
 2. Deponia Sanitare regjionale - Gjilan (Velekincë)
 3. Deponia Sanitare regjionale - Prizren (Landovicë)
 4. Deponia Sanitare komunale - Podujevë (Dumnicë)
 5. Stacioni i transferues i mbeturinave - Ferizaj (Gërlicë)

Neni 2

Deponitë regjionale të KMDK.SH.A (në tekstin e mëtejme deponitë) në kuptim të dispozitave të kësaj rregulloreje, janë deponi sanitare për trajtimin e mbeturinave/mbetjeve jo të rrezikshme komunale dhe të amvisërisë, siç është e përcaktuar me katalogun e mbeturinave nga Ligji Nr. 04/L-060 Ligji për Mbeturina.

Neni 3

- 1) Çdo person juridik që sjell mbeturina komunale, sanitare apo të tjera, të lejueshme për trajtim nga ana e KMDK SH.A., paraprakisht duhet të sjelli kërkesën për sjelljen e mbeturinave me paralogaritje për sasinë vjetore dhe llojin e mbeturinave, kërkesën duhet ta shoqërojë me listën e mbeturinave sipas katalogut.

- 2) KMDK SH.A. pas shqyrtimit të kërkesës, në rast aprovimi të saj, e fton personin juridik për nënshkrim kontrate, nga e cila kontratë dalin edhe detyrimet reciproke. Në rast të refuzimit të kërkesës jepen arsyet e refuzimit.
- 3) Në deponitëe KMDK SH.A. lejohet prurja, hyrja dhe shkarkimi i këtyre llojeve të mbeturinave:
 - a) mbeturinat komunale, respektivisht mbeturinat shtëpiake si dhe mbeturina të tjera të cilat, për shkak të natyrës së tyre, janë të ngjashme ose kanë përbërjeje të ngjashme me mbeturinat shtëpiake,
 - b) mbetjet industriale jo-të rrezikshme me karakteristika të ngjashme të mbeturinave komunale dhe karakteristika të ngjashme të mbeturinave shtëpiake,
 - c) mbetjeve të ndërtimit dhe të demolimeve (fraksioni deri në ϕ 30 cm),
 - d) mbetjet shtëpiake të mobilerisë të demoluara (pajisje elektrike shtëpiake, etj)
 - e) llumrat e ujërave të zeza nga pastrimi i ujërave të zeza, vetëm nëse, përqendrimi i materies së ngurt dhe madhësia fiziko-kimike “**eluate**” nga shpërlarja e këtyre llumërave, përmbushin vlerat e mbeturinave **jo të rrezikshme** për deponim dhe në qoftë se ato janë të dehidruara maksimalisht dhe jo më pak se 30% materie e thatë.
- 4) Listimi i mbeturinave **jo të rrezikshme sipas Katalogut shtetëror të mbeturinave i cili është kompatibil me Katalogun Evropian të mbeturinave** është pjesë përbërëse e kësaj rregullorje e përcaktuar me ANEKS I
- 5) Përfunduar nga paragrafi 1) dhe 2) i këtij neni bëjnë Vendimet apo Urdhëresat e Aksionarit- Qeverisë së Republikës së Kosovës me të cilat KMDK SH.A. obligohet të pranojë mbeturina apo mbetje shtesë për trajtim apo asgjësim dhe e njëjta mbeturinë nuk është pjesë e katalogut për “mbeturinë jo të rrezikshme”.
- 6) Vendimi apo urdhëresa e cila nxirret nga Aksionari, duhet të ketë të përcaktuar edhe tarifën e trajtimit të mbeturinës, në të kundërtën tarifa do të përcaktohet përkohësisht nga Bordi i Drejtorëve pas analizës së koston dhe mënyrës së trajtimit të përpiluar nga sektori i operativës dhe analitika e sektorit financiar.

Neni 4

- 1) Para asgjësimit të mbeturinave të cilat nuk dihet përbërja dhe origjina **duhet të përcaktohet përbërja e mbeturinës eluatit ***.
- 2) Nëse mbetjet e të njëjtit lloj shkarkohen/zbrazen në vazhdimësi të përhershme për deponim, atëherë duhet të bëhet testimi i Eluatit* së paku një herë në vit.
- 3) Menaxheri i deponisë dhe kontrolluesi i mbeturinave gjithashtu mund të kërkojnë përcaktimin e përbërjes së mbetjes eluate për përcaktimin e përbërjes së shpërlarjes së mbeturinave.

* *Elucioni – është ndarje kimike, shpërbërja e substancës e absorbuar në materie të ngurta.*

Neni 5

- 1) Analizat e cekura në paragrafet 2) dhe 3) nga Neni 4 mund të kryhet vetëm nga institucionet profesionale që kanë fuqinë për të nxjerrë raportet e testimit për vetitë fizike dhe kimike të mbeturinave.
- 2) Për procedurat, udhëheqjen dhe arkivimin e dokumentacionit, me rezultatet e fituara nga analizat e raportit sipas paragrafit 1) të këtij Neni, obligohet ti garantojë Teknologu i angazhuar për monitorim.

Neni 6

Në deponi është e ndaluar sjellja dhe asgjësimive çanërisht për:

- a) mbetjet e rrezikshme,
- b) mbetjet e lëngshme/likuide të rrjedhshme (edhe në pikje) **
- c) mbetjet bërthamore, toksike dhe radioaktive,
- d) mbeturinat që përmbajnë asbest,
- e) gazi, kontenerët/enët që përmbajnë gaz nën presion,
- f) Substancat vetëdëzëse dhe lëndet djegëse nga kategoria e parë,
- g) mjetet eksplozuese/shpërthyes,
- h) substancat/materialet cilat në kontakt me ujin reagojnë dhunshëm, veçanërisht duke rritur temperaturën dhe sasinë e gazrave,
- i) mbetjet infektive spitalore dhe klinike nga institucionet mjekësore dhe veterinarë,
- j) mbeturinat nga përgatitja dhe përpunimi i mishit dhe ushqime të tjera me origjinë shtazore,
- k) trupat e kafshëve,
- l) mbetjet industriale që dalin nga proceset dhe trajtimin teknologjik të substancave të rrezikshme.

** Mbetjet e ndaluara për hedhje në paketim kasetë

Neni 7

Mbeturinat që konsiderohet të rrezikshme, janë përcaktuar në Ligjin Nr. 04/L-060 Ligj për Mbeturina, si dhe në nomenklaturën e katalogut, për shembull;

- a) acidet dhe bazat,
- b) depozitat-llymrat engjyrave dhe llaçnave (bojë & llak) dhe mbetjet nga prodhimin e ngjyrave dhe llaqet,
- c) llumërat galvanike (të panatyrshme),
- d) shllirat/skorjet agresive,
- e) filter pluhur,
- f) agjentët/materialet e mbrojtjes bimore [pesticide, insekticide, herbicide, fungicide /kërpudhëvrasës],
- g) mbeturinat tjera të kimikateve të ndryshme etj.

Neni 8

“Rreptesisht është e ndaluar” pranimit mbeturinave/mbetjeve me përbërje, përmbajtje dhe origjinë të panjohur.

Neni 9

Nëse, pas shkarkimit të mbeturinës, konstatohet se në deponi është sjellë mbeturinë që është e ndaluar për hedhje në deponitë e KMDK SH.A., atëherë mbeturina e sjellur, do të ringarkohet dhe do të kthehet furnizuesit/klientit qoftë ai privat apo publik dhe kostoja e shpenzimeve bie mbi furnitorin përfshirë edhe peshimin dhe koston e makinerisë për ngarkim, dhe për këtë shpërdorim të mirëbesimit do të bëhet fletëparaqitje në Inspektoriatin Kompetent.

Neni 10

- 1) Mbeturina e mbledhur nëse nuk/është e ndarë, mund të ndahet dhe të shfrytëzohet për përdorim dhe shitje për shkak të vlerës së materies qëka (psh. letra, qelqi, tekstil, plastikë, mbeturinave gomë, mbeturinave metalike, etj).

- 2) Në deponi, kasetat/kontonierëtnuk mund të hidhen për groposje, por udhëzohet për dërgim në depot e ricklimit, në biokompostishte, gomat apo mbeturinat e rënda metalike të magazinohen/deponohen përkohësisht, ndërsa mbetjet e ndërtimit vendosen në ndonjë hapësirë të përcaktuar për këtë në kuadër të deponisë.

KAPITULLIII

HYRJA-PRANIMI I MBETURINAVE NË DEPONI

Neni 11

Automjetet që sjellin mbeturinë/mbetje, do të peshohen dhe të regjistrohen nga urëmatësi i peshoresnë hyrje dhe dalje të deponive të KMDK SH.A.

Neni 12

Personi i cili sjellë mbeturina, obligohetqë peshëmatësit ti japë deklaratë në lidhje me origjinën dhe llojin e mbeturinave, ndërsa mënyra e pagesësnga klientët e kontraktuar bëhet përmes shërbimeve bankare dhe duhet të kryhet deri më datën 10 të muajit vijues, apo 7 ditë pas dorëzimit të faturave.

Neni 13

Vozitësi që sjell mbeturina, pas zbrazjes së tyre, duhet që para daljes të ndalojë automjetin në vendin e paraparë për larje të rrotavedhe të presë derisa ato të jenë pastruara.

Neni 14

Në rast se vozitësi për ndonjë arsye tërhiqet nga zbrazjae mbeturinave ose i ndalohet zbrazja e mbeturinavepër shkak të tentim zbrazjes së palejuar, ndaj tij bëhet fletparaqitja në inspektoriatin kompetent.

Neni 15

- 1) Në Deponi mundësohet/lejohet hyrja vetëm për personat dhe automjetet për nevoja zyrtare, dhe për të cilat në hyrje te kabina apo te personi i shërbimit tësigurimit, mbahet evidenca me të dhëna në librin e regjistrimit/softver.
- 2) Hyrja u lejohet posaqërisht personave dhe automjeteve për periudhën e kryerjessë punime investuese, sanuese apo të rehabilitimit të deponisë gjithashtu edhe në këto raste mbahen shënime të hyrje –daljeve dhe evidentohen në librin e regjistrimit/softver.
- 3) Rreptësisht është e ndaluar hyrja e personave të pautorizuar në deponi dhe veprimet e tilla, cilësohen si ndërhyrje në aktivitetin dhe sigurinë e deponisë, ndërsa shkalla e rrezikshmerisëështë e lartë dhe pasojat juridike do ti bartë personi/personat ilegal.
- 4) Drejtoria operative është e obliguar të përgatisë një plan operativ për parandalimin dhe dekurajimin e personave që ndërhyjnë në zonën e rrethuar të deponisë.

Neni 16

Rregullat e qarkullimit të brendshëm dhe siguria

- 1) Lëvizja e automjeteve brenda deponisë, bëhet në pajtim me kushtet dhe përcaktimet kufizuese si dhepër shpejtësitë e lejuara të transportuesëve të mbeturinave si në vijim:
 - a) Të gjithë udhëtarët e automjeteve duhet të lidhen (përdorin rripin e sigurisë).
 - b) Të gjitha automjetet duhet të kenë të ndezura dritat gjatë gjithë ditës.
 - c) Shpejtësia maksimale për të gjitha automjetet brenda në objekt është 10km/h.



- d) Në pjesët e pjerrëta, shpejtësia maksimale për të gjitha automjetet është 5km/h.
 - e) Kamionët (transportuesit e mbeturinave) duhet të përdorin shpejtësinë e parë dhe frenat.
- 2) Lëvizja e këmbësorëve brenda deponisë nuk është e lejuar, përveçse në rrugët e shënuara për puntorët e operativës.

KAPITULLI III PRANIMI DHE MËNYRA E TRAJTIMIT TË MBETURINAVE

Neni 17

- 1) Në hyrje të deponisë, duhet të kontrollohet dhe regjistrohet sasia dhe lloji i mbeturinave që sillen për deponim.
- 2) Përcaktimi i llojit të mbeturinave bëhet me anë të inspektimit vizuel dhe nga deklarimi i vozitësit për të cilën ai mbanë përgjegjësi, ndërsa sasia peshohet/matet.

Neni 18

- 1) Pas matjes dhe peshimit të mbeturinave, automjeti udhëzohet dhe drejtohet për zbrazje në vendin/sectorin e përcaktuar nga Menaxheri i deponisë apo Drejtori i operativës.
- 2) Në vendin e zbrazjes (gjatë shkarkimit) do të ketë kontrollë vizuale shtesë nga zyrtari i përcaktuar nga Menaxheri i deponisë, për llojin e mbeturinave dhe për të cilën kontrollë ka procedurë të veçantë.

Neni 19

- 1) Prodhuesi ose operatori i cili sjell **mbeturina industriale** është i obliguar që urëmatësit të kompanisë në hyrje, ti dorëzojë "**listën përcjellëse konfirmuese**" me të cilën lejohet deponimi dhe se ky material nuk është i rrezikshëm për deponim, listës përcjellëse i bashkëngjitet edhe raporti i analizës së eluatit*.
- 2) Për saktësinë e të dhënave të përcaktuara në listën përcjellëse, përgjegjësia bie mbi operatorin që sjell mbeturinën.

Neni 20

- 1) Në rast të mungesës së dokumentacionit sipas Nenin 19, të kësaj rregulloreje, ndalohet në hyrjepranimit i mbeturinave.
- 2) Çdo përpjekje për të hyrë me mbetje industriale qofshin ato edhe të parrezikshme por që nuk shoqërohen me "**listë përcjellëse konfirmuese**" do të evidentohet dhe trajtohet si shkelje e kontratës për shfrytëzimin e deponive.

Neni 21

- 1) Pas zbrazjës së mbeturinave qoftë nga kamionët apo kontenierët, mbeturina duhet të shtrihet dhe të kompaktohet me makineri adekuate (kompactor, buldozerë dhe të tjera).
- 2) Procedurat dhe veprimet për trajtim të mbeturinave, bëhen sipas standardeve gjenerale për operim dhe menaxhimin të deponive sanitare të mbeturinave si dhe sipas Udhëzuesit/manualëve për operim në deponi.
- 3) Opsionet e ndarjes apo të riciklimit të mbeturinave do të trajtohen nga menaxhmenti i KMDK SH.A. dhe për to vendos Bordi i Drejtorëve duke përcaktuar pikat dhe hapësirat e nevojshme brenda deponive.
- 4) Procesi i ndarjes dhe riciklimit do të rregullohet me akt të veçantë.



Neni 22

- 1) Evidencat nga peshimi dhe faturimi për pagesë bëhen në formë digjitale apo klasike (kur nuk ka rrymë) dhe në 3 kopje, ndërsa në “përmbajtja e të dhënave” përfshinë:
 - a) Emërtimi i Deponisë.
 - b) Data dhe koha e hyrjes.
 - c) Lloji i mbeturinave.
 - d) Identifikimi i subjektit dhe transportuesit.
 - e) Emri dhe mbiemri i personit që pranon mbeturinën.
 - f) Sasinë bruto të kamionit të ngarkuar.
 - g) Peshën e automjetit (transportuesit) të zbrazur.
 - h) Peshën netto të mbeturinës së deponuar.
 - i) Emrin dhe mbiemrin e dërguesit dhe nënshkrimi.
- 2) Formularët e pagesës janë të përcaktuar sipas ANEKSIT II të kësaj Rregullorje.
- 3) Të dhënat dhe evidencat për shërbimete kryera të pranimit të mbeturinave i mbajnë dhe udhëheqin zyrtarët KMDK SH.A të caktuar për këtë punë.

KAPITULLI IV MASAT E MBROJTJES SË MJEDISIT

Neni 23

- 1) Në deponi është e nevojshme të bëhen matjet për :
 - a) parametrat meteorologjik,
 - b) cilësinë e ajrit,
 - c) ujërat nëntokësore,
 - d) rrjedhjen dhe kullimin e ujërave sipërfaqësore dhe
 - e) gazin e deponisë.
- 2) Matjet e referuara në paragrafin 1 të këtij neni, si dhe monitorimi i florës dhe faunës në deponi, kryhen sipas Ligjit dhe Planit të Veprimit për Mjedisin për vitin aktual. Në pamundësi financiare të kryerjes së tërësishme të këtyre analizave, KMDK SH.A. duhet të kërkojë mbështetje nga Aksionari apo donatorët.

Neni 24

- 1) Në deponi duhet të ndërmerren masa dhe veprime për të parandaluar:
 - a) përhapjen e erës,
 - b) pluhurit,
 - c) aerosoleve (të lëngëtapo të ngurtë),
 - d) formimin e zhurmës,
 - e) kundërmimin,
 - f) grumbullimin e shpezëve,
 - g) grumbullimin e qenëve endacakë,
 - h) brejtësit dhe
 - i) insektet që mbajnë mbeturina.

- 2) Drejtoria e Operativës dhe Njësia/Sektorit për ambient, duhet të përgatisin planveprimin për zvoglimin e nivelit të ndotjes përmes mbulueshmërisë ditore me dhe, spërkatjes me ujë në kohë të thatë si dhe zbatimin e veprimeve Dezinftuese, Deratizuese dhe Dezinsektuese.
- 3) Njësia/Sektorit për mbrojtjen e ambientit, duhet të përgatisë dhe të zbatojë një plan ekologjik, duke mbjellur drunjë të rinj, mirëmbajtje të brezit gjelbërues në veçanti pjesa hyrëse e deponisë, të jetë në kondita pune ekologjike dhe të ketë pamje.

KAPITULLI V MASAT MBROJTËSE NGA ZJARRI

Neni 25

- 1) Mbrojtja nga zjarri dhe veprimet që duhet të ndërmerren në rast të zjarrit, duhet të bëhen në përputhje me rregulloret e veçanta dhe akteve të përgjithshme të kompanisë, në veçanti sipas dispozitave rregullore të veçantë për mbrojtje nga zjarri si dhe të elaboratit (dokument studimor) për mbrojtjen nga zjarri.
- 2) Rregullorja dhe Elaborati i cekur në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të hartohen nga Eksperti/profesionisti i punësuar për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe ato duhet të jenë në dispozicion të Bordit Menaxhues, Kryeshefi Ekzekutiv, Drejtorit të Operativës si dhe të Drejtorëve teknik/Menaxherëve të deponive.
- 3) Pjesa udhëzuese grafike, për mbrojtje nga zjarri e cila gjendet brenda rregullores /elaborati, po e njëjta duhet të jetë e shkëputur dhe e zmadhuar në përmasa të mjaftueshme fizike për dukje dhe lexim dhe të vendoset në muret e objekteve të deponisë, përfshirë edhe selinë e kompanisë.

Neni 26

- 1) Punëkryesit, kontraktorët e punimeve ose ofruesit e shërbimeve, janë të detyruar të zbatojnë masat e mbrojtjes nga zjarri, 24 orë pandërprerje, dhe po ashtu në vazhdimësi çdo ditë janë përgjegjës për parandalimin e zjarrit dhe duke bërë planet e nevojshme në rast të zjarrit, janë përgjegjës për të marrë të gjitha masat e nevojshme në kryerjen e punimeve sanuese dhe të riparimit, në zonën e burimit apo në zonën e deponisë.
- 2) Për çdo situatë, incident apo aksident, punëkryesit/kontraktorët e punimeve ose ofruesit e shërbimeve, janë të detyruar të raportojnë shkrim menjëherë Bordin Menaxhues, dhe jo më vonë se 24 orë.
- 3) Dispozitat nga paragrafet 1), dhe 2) të këtij Neni, janë pjesë përbërëse e detyrimeve kontraktuale në mes të KMDK SH.A. dhe kontraktorit për punëapo shërbim.

Neni 27

- 1) Deponitë duhet të jenë të pajisura me aparate për shuarje dhe kontroll të zjarrit, pajisje për alarm, pajisje të tjera mbrojtëse dhe të sistemeve instaluese, si dhe shenjat dhe tabelat për ndalesa dhe rreziqe.
- 2) Përmbajtja, forma si dhe sasia e shenjave për informim, ndalesa, kufizime dhe për rreziqe, do të rregullohen me akt të veçantë.

Neni 28

- 1) Në rast të shpërthimit të zjarrit në zonën e deponive, është obligative që menjëherë të telefonohet shërbimi i zjarrfikëseve dhe emregjencave ndërsa deri në arritjen e shërbimit, punëtorët e deponisë, duhet të përqipen për ta shuar vet ose për ta vënë nën kontroll zjarrin, duke përdorur pajisjet dhe mjetet disponuese kundër zjarrit.



- 2) Një sasi e dheut duhet të jetë në dispozicion të deponisë, për të vepruar shpejt në mbulimin e paraqitjes së vatrës së zjarrit.
- 3) Punonjësit e deponisë e kanë për detyrë që për çdo shpërthim të zjarrit, të lajmrojnë menjëherë Menaxherin/Drejtorin, Udhëheqësin e Njesisë së kontrollës së brendshme dhe Drejtorin e Operativës.

KAPITULLI VI ORGANIZIMI I PUNËS

Neni 29

Orari i punës në deponi për shërbimet e deponisë, duhet të jetë i përcaktuar me vendim të orarit të punës dhe i njëjti të jetë publik në tabelën e shpalljeve në hyrje të deponisë.

Neni 30

- 1) Për të siguruar kushtet e nevojshme të punës, Deponia duhet të jetë e pajisur me objektet dhe pajisjet e nevojshme, e në veçanti:
 - a) Rrethoja/gardhi.
 - b) Objektet për kontroll, (akomodim të personelit dhe pajisjeve).
 - c) Hapësirë për zyre, dhomë për gardërobë dhe kujdestari si dhe nyje sanitare/WC.
 - d) Peshoretme pajisjet kompjuterike/digjitale dhe informatike adekuate si dhe peshimi mekanik.
 - e) Videosistemi për navigim/mbikëqyrje.
 - f) Aparat për monitorim të ajrit/radioaktivitetit.
 - g) Piezometrat.
 - h) Plato për larje të gomave.
 - i) Një depo për pajisje, veshje, dhe pjesë rezervë.
 - j) Një garazh gjysëm tëhapur për pjesë të ndërruara, akumulatorë të vjetër dhe për makina/pjesë metalike për shitje.
 - k) Sektorin rezervë, hapsirë e planifikuar dhe e përcaktuar me vendim për vendosjen e objekteve për ndarje dhe teknologji ricikluese.
 - l) Kontejnerët për bartje tëmbeturinave tëpërdorshme bashkë me listën shoqëruese.
 - m) Çasje për nërrugën publike.
 - n) Rampat, tabelat orientuese për lëvizje të makinave dhe shenjat e kujdesit.
- 2) Në kabinën pranuese, duhet të jenë në dispozicion:
 - a) Plan/skica e deponisë me të dhënat e qarta grafike dhe tekstuale.
 - b) Lista e telefonave për menaxhmentin dhe kontrollën e brendshme të KMDK SH.A.
 - c) Lista e telefonave për shërbimet emergjente të zjarrfikësve, ndihmës së shpejtë dhe policisë.
 - d) Udhëzuesi grafik për veprime të mbrojtjes nga zjarri.
 - e) Udhëzuesi grafik për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale.
 - f) Aparati për zjarrfikje dhe
 - g) Kutia e ndihmës së parë.



Neni 31

- 1) Organizimi i punës bëhet nga Menaxheri/Drejtori i Deponisë në bashkëpunim me Drejtorin e Operativës, ndërsa përshkrimi i detyrave të punës është i përcaktuar me Rregulloren e veçantë të KMDK SHA “Për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës”.
- 2) Krijimi i kushteve të punës për punëtorët në deponi është pjesë e kontratës sipas Ligjit të punës, dhe Ligjin për shëndetin dhe siguri në punë.
- 3) Detajizimi i masave të përgjithshme mbrojtëse për shëndetin dhe sigurinë, do të bëhet me akt/rregullore të veçantë të KMDK SH.A. si dhe me manualët/doracakët që do ti hartojë eksperti i fushës.
- 4) Eksperti/profesionisti i punësuar për sigurinë dhe shëndetin në punë përmes rregullores së veçantë, do të përcaktojë masat mbrojtëse shëndetsore si dhe veprimet parandaluese të rreziqeve në punë.

Neni 32

- 1) Të gjithë të punësuarit në deponi, duhet të jenë të informuar dhe të udhëzuar për punën që bëjnë, për mënyrën e punës, rreziqet dhe masat për mbrojtjen dhe sigurinë në punë, ata duhet të jenë të përgatitur dhe të trajnohen për mbrojtjen nga zjarri.
- 2) Konfirmimi/dëshmia e përgatitjes për mbrojtje në punë dhe nga zjarri, bëhet nga institucionet e autorizuara, si dhe nga teste të brendshme sprovuese të cilat i përpilon dhe i zbaton personi i specializuar/eksperti sipas ligjit për siguri në punë.

Neni 33

Me aktin e përgjithshëm përkatësisht me Ligjin Nr. 04/L-161, “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë” janë përcaktuar masat e mbrojtjes në punë, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në zbatimin e dispozitave të sigurisë në punë, si dhe sistemi rregullativ i mbrojtjes në punë me zbatimin e të cilave në masë të madhe arrihet parandalimi ilëndimeve, sëmundjeve profesionale, dhe sëmundjeve tjera që lidhen me punën dhe mbrojtjen e mjedisit të punës.

Neni 34

Shërbimi i mbrojtjes në punë, funksionon 24 orë pandërprerë çdo ditë për shkak të:

- a) Mbajtjes së rendit – pamundësimi i hyrjes së paautorizuar.
- b) Parandalimit të shpërthimit dhe përhapjes së zjarrit dhe të lajmërimit të zjarrit.
- c) Parandalimin e përzgjedhjes dhe të marrjes së mbeturinave.
- d) Parandalimin e heqjes dhe prishjes së mbeturinave të sistemuara.
- e) Parandalimin e sjelljes së kafshëve shtëpiake për kullotë.
- f) Parandalimin e të gjitha veprimeve tjera të cilat mund të rrezikojnë njerëzit, të dëmtojnë asetet materiale e teknike si dhe të pengojnë procesin teknologjik në deponi.
- g) Parandalimin e marrjes së paautorizuar të materialit rrethor.

KAPITULLI VII DOKUMENTIMI

Neni 35

Çdonjëra nga Deponitë është e obliguar të mbajë një **Ditar** për deponimin e mbeturinave në të cilin ditat evidentohen të dhënat e rëndësishme për punën/aktivitetin e deponisë, dhe veçanërisht të dhënat:

- a) për zonën e deponimit, mbulimit dhe të mirëmbajtjes së mbeturinave të sistemuara, llojet dhe sasi të mbeturinave të pranuar dhe të deponuara,
- b) për monitorimin e sistemit, përbërjes dhe sasisë së gazit të deponisë,
- c) për evidentimin dhe monitorimin e rrjedhave sipërfaqësore, prurjes së ujërave nga shiu dhe sasia e kullimit, si dhe të cilësisë së ujërave nëntokësore,
- d) për mirëmbajtjen dhe monitorimin e nivelit të lagunave, si dhe
- e) rikultivimin e pjesëve të mbushura/të përfunduara për pranimitë mbeturinës në zonën e caktuar të deponisë.

Neni 36

Pjesë përbërse/integrale e Ditarit të Deponisë është:

- a) Dokumentacioni mbi mbeturinat (fletëpërcjelljet për mbeturina, analiza eluate* të mbeturinave etj).
- b) Të dhënat për makineritë dhe pajisjet teknike dhe teknologjike.
- c) Të dhënat për materialin ndërtimor në deponi.
- d) Të dhënat për ndërmarrjen e masave/rishikimin sipas urdhërit të inspektimit të mjedisit.
- e) Të dhënat nga rishikimi dhe monitorimi të ndodhive natyrore (vërshimet, tërmetet, etj) dhe
- f) Të dhënat nga ngjarjet e paparashikuara (zjarre, shpërthime, situata konflikti midis punonjësve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve, etj) në deponi.

Neni 37

- 1) Të gjitha matjet dhe rezultatet sipas Neni 23, të kësaj Rregulloreje, si dhe të dhënat për llojin dhe sasinë e mbeturinave të pranuar, duhet të regjistrohen/evidentohen brenda "Ditarit të Deponisë".
- 2) Drejtori i Operativës organizon dhe mbikëqyrëdhëheqjen/menaxhimin e ditarëve dhe të dhënat e futura, dhe rregullisht nënvizon e mungesën apo risinë e informacionit.
- 3) Në fund të vitit, dokumentacioni i përmbyllur sillet në Arkivin e KMDK SH.A. për sistemim dhe ruajtje.

Neni 38

Me planin vjetor/Biznes Planin KMDK SH.A. projektton dhe planifikon për:

- a) sasinë vjetore dhe llojin e mbeturinave,
- b) kapacitetin dhe rregullsinë e pajisjeve teknike dhe teknologjike nëpër deponi,
- c) numrin i të punësuarve,
- d) masat për mbrojtjen e mjedisit dhe
- e) burimet e nevojshme financiare.

KAPITULLI VIII

VEPRIMET E PËRKOHSHME KUFIZUESE DHE MBYLLJA PËRFUNDIMTAREE DEPONIVE

Neni 39

Veprimet e përkohshme kufizuese

- 1) Masat kufizuese apo mbyllja e përkohshme e deponisë mund të bëhet për këto arsye:
 - a) Për shkak të vlerësimit të rrezikshmërisë së lartë për jetën, shëndetin dhe pasurinë e qytetarëve.



- b) Për shkak të pamundësisë teknike e financiare për pranim dhe menaxhim të mbeturinave apo sektorëve të veçantë, me qëllim të parandalimit të daljes së situatës jashtë kontrollit.
 - c) Për shkak të punimeve rehabilituese apo të rekonstruktive, si dhe
 - d) Si masë kufizuese e ndërmarrënga Menaxhmenti ndaj klientëve që nuk i përmbahen kushteve, kritereve dhe afatit të pagesës të përcaktuar me kontratë.
- 2) Masa kufizuese apo mbyllja e përkohëshme e deponisë caktuar, për shkaqet e cekura nga paragrafi 1) i këtij neni, mund të bëhet vetëm me vendim të Organit Kompetent, (Qeverisë, Gjykatës, Inspektoriatit të mjedisit apo me Vendim të Bordit të KMDK SH.A).

Neni 40

Mbyllja përfundimtare deponive

- 1) Deponia duhet të mbyllet, atëherë kur konstatohet se mënuk ka kapacitet për pranim të mbeturinave, apo në rast kur emetimi i ndotësve në mjedis tejkalon vlerat e specifikuar të emetimeve dhe rehabilitimi nuk mund të zvogëlojë ndikimin negativ të deponive në shëndetin e njeriut dhe të mjedisit.
- 2) Deponia e konsumuar dhe e mbushur sipas planifikimit të jetëgjatësisë duhet të mbyllet dhe paraprakisht përgatitet Plani i mbylljes së deponisë së caktuar.
- 3) Plani i mbylljes duhet të shoqërohet me një studim të detajuar, i cili do të përmbajë të gjitha procedurat, kushtet, kriteret, fazat dhe udhëzimet standarde për tu konsideruar deponi e mbyllur.
- 4) Kurse njoftimi për mbylljen e deponisë dhe procedurat tjera, do të ndiqen nga Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2012 për Menaxhimin e Deponive të Mbeturinave.

KAPITULLI IX

KONTROLLA E BRENDSHME INSPEKTUESE

Neni 41

- 1) KMDK SH.A. përmes njësisë së brendshme të kontrollës inspektuese, do të monitorojë zbatimin e dispozitave të kësaj rregullorje.
- 2) Organizimi dhe detyrat e njësisë së brendshme kontrolluese është e përcaktuar me rregulloren për Organizim dhe sistematizim të vendeve të punës.
- 3) Inspektimi duhet të ketë formë standarde e me udhëzime për zbatim dhe raportim, dhe përgatitet një formular i detajuar sipas ANEKSIT III.
- 4) Zbatimi i formës dhe përdorimi i formularëve duhet të ndihmojë në ruajtjen e procedurës dhe në qëndrueshmërinë e informacionit.
- 5) Puna inspektuese për makineri të rëndësishme e përcaktuar me rregulloren e veçantë.
- 6) Kontrolla e brendshme Inspektuese për punën e vet për të ruajtur paanshmërinë nga operativa, i raporton drejtpërdrejtë Kryeshefit Ekzekutiv.

KAPITULLI X

MËNYRA E PAGESËS DHE TARIFAT E SHËRBIMIT /ÇMIMI I TRAJTIMIT TË MBETURINAVE

Neni 42

- 1) KMDK SHA për shërbimete ofruara në trajtim dhe menaxhim të mbeturinave, paguhet sipas tarifave të përcaktuara nga organi kompetent.
- 2) Mënyra e pagesës bëhet përmes xhironlogarisë bankare.

- 3) Nëqdo fundvit, Zyrtari i lartë financiar bashkë me sektorin e analitikës dhe me Drejtorinë e Operativës, nxjerrin raport detaj mbi koston e tarifës shpenzuese për menaxhim optimal në trajtim të mbeturinës të llogaritur për ton [€___/ton], nga i cili raport, Bordi i Drejtorëve vendos me vendim, adresimin e qështjes me kërkesë për zgjidhje dhe për përcaktim të tarifës.
- 4) Tarifa e vetëvlerësuar sipas paragrafit 3). të këtij neni, duhet të analizojë me detaje të gjithë parametrat e shpenzimeve të trajtimit dhe mirëmbajtjes, përfshirë:
 - a) Veprimet e përditëshme operacionale.
 - b) Infrastrukturën fizike e teknike, makineritë.
 - c) Sistemet elektrike, hidroteknike/hidraulike, dhe të gazit.
 - d) Objektet përcjellëse dhe të mirëmbajtjes.
 - e) Kujdesin ndaj ambientit, mbrojtjen e shëndetit dhe të sigurisë, si dhe
 - f) Koston personelit të angazhuar.
- 5) Tarifa është indikator kryesor me të cilin matet performanca e KMDK SH.A. dhe varësisht nga % e mbulueshmërisë së shpenzimeve me tarifë, për aq % trajtohet dhe menaxhohet mbeturina.

KAPITULLI XI DISPOZITAT PËRJASHTUESE

Neni 43

- 1) Mundësia e paraqitjes dhe shfaqjes së rreziqeve dhe të fatkeqësive, sa i përket llagunes në Mirash, shtresës djegëse të qymyrit në Mirash si dhe Kontenieri me mbetje të rrezikshme në Dumnicë nuk mund të jenë objekt i përgjegjësisë së menaxhmentit dhe operativës së KMDK SH.A. për të evidentuarat e mëposhtme:
 - a) Deponia në Mirash është projektuar dhe konstruktuar në një teren jo të përshtatshëm gjeologjik dhe forma sinklinale është pengesë për trajtimin e ujërave të zeza, ndërsa rrëshqitjet masive anësore të shpatijeve rreth llagunës, janë potencial i përhershëm për përmbytje edhe të sektorit të deponisë.
 - b) Shtresat vetëndezëse të qymyrit në shpatijet e trupit të deponisë, nuk mund të menaxhohen sepse burimet ndezëse vijnë nga shtresat e nëndheshme.
 - c) Kontenieri i vendosur në Dumnicë me materie të rrezikshme, nuk është pronë e KMDK SH.A, është sjellur në një periudhë pa i respektuar të drejtat dhe obligimet e KMDK SH.A. e cila nuk ka potencial as teknik e as profesional për trajtim dhe siguri.
- 2) Zonat dhe objektet e cekura nga paragrafi 1i këtij neni, do të shenjëzohen dhe rrethohen me shirita paralajmërues për rrezikshmeri të lartë.
- 3) Përgjashtim nga dispozitat e kësaj rregulloreje bëjnë kodet: 200101; 200139; 200140; 200102; 200110; 200111; 200136 për materialet e specifikuar në ANEKSIN I dhe tabela me Listën e mbeturinave të pranuar në Deponitë Sanitare të menaxhuara nga KMDK SH.A, për një periudhë të caktuar kohore deri në afatin e gatishmërisë tekniko-financiare e KMDK SH.A për ndarje dhe riciklim.
- 4) KMDK SH.A, po ashtu do të zbatojë deri në një akt tjetër, vendimin e Ministrit të MMPH-së “që ka të bëjë me pranimin e mbetjeve shtazore” të cilat do të evidentohen sipas “kategorisë së kodit 0202 mbeturinave nga përgatitja dhe përpunimi i mishit, peshkut dhe ushqimeve të tjera me origjinë shtazore” respektivisht kodit 020203, material jo i përshtatshëm për konsumim apo përpunim.


KAPITULLI XII DISPOZITATPËRFUNDIMTARE

Neni 44


- 1) Pjesë përbërëse të kësaj Rregullore janë edhe anekset:
Aneksi I: Lista e mbeturinave të pranuar në Deponitë sanitare të KMDK
Aneksi II: Forma dhe përmbajtja e Flete Dërgesës për pagesë
Aneksi III: Raporti i inspektimit
Aneksi IV Faturë
- 2) Për çdo paqartësi apo konflikt të dispozitave të kësaj rregulloreje, Ligjet në fuqi dhe Statuti i Kompanisë mbizotërojnë mbi këtë rregullore. Në raste të tilla dispozitat përkatëse të kësaj rregulloreje konsiderohen të revokuara, ose ndryshuara në masën e nevojshme për eliminimin e mos përputhjes me ndonjë dispozite të Ligjeve apo Statutit të KMDK-se.
- 3) Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën pasi të jetë miratuar nga Bordi i Drejtorëve dhe të jetë nënshkruar nga ana e Kryesuesit të Bordit të KMDK SH.A.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve në KMDK SH.A.

Lundrim Camaj



Prishtinë, 31/07 2017




ANEKSI I

Lista e mbeturinave të pranuar në Deponitë sanitare të menaxhuara nga KMDK SHA

Kodi i mbeturinës	Emri i mbeturinës	Shkalla e rrezikshmërisë
20	Mbeturinat Komunale (Shtëpiake dhe ato të ngjashme komerciale, industriale dhe institucionale) përfshirë edhe fraksionet e mbledhura ndaras	
20 03 01	Mbeturinat e përziera komunale	Jo të rrezikshme
20 01 01	Letër dhe karton	Jo të rrezikshme
20 01 39	Plastika	Jo të rrezikshme
20 01 40	Metalet	Jo të rrezikshme
20 01 02	Qelqi	Jo të rrezikshme
20 01 10	Veshjet	Jo të rrezikshme
20 01 11	Tekstili	Jo të rrezikshme
20 02 02	Dheu dhe gurët	Jo të rrezikshme
20 02 01	Mbeturinat që mund të kompostohen	Jo të rrezikshme
20 02 03	Mbeturinat tjera jo bio degraduese	Jo të rrezikshme
20 03 99	Mbeturinat komunale të pa specifikuar ndryshe	Jo të rrezikshme
20 01 36	Pajisjet elektrike dhe elektronike për hedhje, tjera nga ato të përmendura në 20 01 21, 20 01 23 dhe 20 01 35	Jo të rrezikshme
17	Mbeturinat nga konstruktimi dhe demolimi	Jo të rrezikshme
17 05 04	Dhera dhe gurë, tjera nga ato të përmendura në 17 05 03*	Jo të rrezikshme
17 01 07	Përzierje të betonit, tullave, tjegullave dhe qeramikës, tjera nga ato të përmendura në 17 01 06*	Jo të rrezikshme

Vërejtje: Grupet e mbeturinave - dheu dhe gurët si dhe mbeturinat me kodë, 17: 17 05 04: 17 01 07 duhet të shfrytëzohen për rregullimin e infrastrukturës rrugore në deponi ndërsa dheu për mbulimin e mbeturinave në baza të rregullta.



ANEKS II

Model i Formes dhe përmbajtja e flete-dërgesës për pagese e cila regjistrohet ne momentin e peshimit te Transportueseve me mbeturine

Flete Dërgesa Manuale

FLETËDËSHMI E URËS MATËSE TË MBETURINAVE

DOKAZNA LISTA ZA MERENJE OTPADA
EVIDENCE SHEET FOR WEIGHT BRIDGE

Kompania për Menaxhimin e Deponive ne Kosove SHA
Adresa: Rr. Musine Kokollari -1. Dardani, Prishtine, Kosove
Numri i Biznesit/Broj biznesa: 70324870
Numri Fiskal/Fiskalni broj:: 600215570
Numri i TVSH/PDV broj: 2013817

Nr.Serik i Fletëpagesës: **0** _____ DP

Data _____ ora _____


Deponia Sanitare ne Mirash - Prishtine

Deponia Sanitare ne Landovicë - Prizren

Deponia Sanitare ne Velekincë - Gjilan

Deponia Sanitare ne Dumnicë - Podujeve

Stacioni i transferit ne Gërlicë - Ferizaj



Emri i subjektit që sjell mbeturinë dhe lloji i automjetit/targa:
Naziv entiteta koji donosi otpad i tip vozila/tablice:
Name of subject that brings waste and number of plates/table:

Lloji i mbeturinës dhe Kodi
Type of waste and code
Vrsta koda otpada

Pesha hyrëse Težinaunos Entryweight	Pesha Dalëse OdlazećiTežina Outryweight	Total [Kg]	Çmimi Cena Price Euro €	TVSH VAT Euro € 8 %	Për pagesë To be paid za placenje Euro [€]
---	---	---------------	----------------------------------	------------------------------	---

Mbeturinë e përzier komunale/Mešoviti municipal waste	komunalni otpad/Mixed	200301			
Dheu dhe gurët / Zemljišta i kamenje / Soil and Stones		170504			
Mbeturinat nga indet e shtazëve		020202			
Material jo i përshtatshëm për konsumim apo përpunim		020203			

Gjithsejtë ne Euro[€]/Ukupno [€]/Total[€]

**Emri dhe mbiemri i personit që sjell mbeturinë /
Ime i prezime osobe koja je dovela otpad:**

**Emri dhe mbiemri i personit që pranon mbeturinë
/ Ime i prezime osobe koja prima otpad**

**Emri dhe mbiemri Menaxherit të Deponisë Sanitare
/ Ime i prezime Menagera sanitarne deponije**

Nënshkrimi: _____

Nënshkrimi: _____

Nënshkrimi: _____
Vula /pecat\ Stamp _____ v.v

Vërejtje/Opomena/Remarks:

Origjinali fleta e bardhë – KMDK/Originalni beli papir za KUDK

Fleta e kaltër – Operusi i Deponisë/Plavi list –
operatori deponije

Fleta e verdhë- Konsumatori/Zuti list - klienti

***Shënim:** Ne zbatim te vendimit lëshuar nga Ministrit te MMPH, KMDK përkohësisht pranon edhe mbeturinat sipas kodeve :020203
Menaxheri i Deponise, nënshkruhet ne rubrikën e përcaktuar ekskluzivisht për fletën e bardhë dhe te kaltër si dhe te kalkulohet çmimi total për pagese para se te dorëzohen ne sektorin financiar

Model i Formes dhe përmbajtja e flete-dërgesës digjitale për pagese e cila regjistrohet ne momentin e peshimit te Transportueseve me mbeturine

Flete Dërgesa digjitale

155-445-111


11799
LUCED 06-321-AR
ECU NIGJENHA 3111
PBE HURIN
XXX
3111
D. S. VELEKINC-GJILAN
XXX
108-Maj-17 9:02:15 PM
108-Maj-17 9:02:15 PM

1 - PESHIMI I PARE \$12480 KG
2 - PESHIMI I DYTE \$19700 KG

NET WEIGHT \$ 7320 KG

Client: *AGRON MISINI Prizren* (KODI: *Jokup Mustic*)

Responsible & Performance Weighing Company
"TERRAKAP" sht.p.k.
Tel: 003839711320 & 003774424477





Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A
Kosovo Landfill Management Company J.S.C
Tel: 038 544 551, 544 552
Adresa: Rr. Musine Kokollari -1 Dardani
Prishtinë, Kosovë

ANEKSI III RAPORTI I INSPEKTIMIT

RAPORTI INSPEKTUES NE DEPONINE SANITARE: _____			
Emri i inspektorit/kontrollës			
Data dhe ora			
Koha			
ZONA E HYRJES			
	Ne rregull	Jo ne rregull	Vërejtje
Tabela e kompanisë te porta me te dhënat			
Porta			
Rampa			
Rrethoja			
Rruga para hyrjes			
Kushtet e rrugëve			
Shenjat informuese dhe paralajmëruese			
Kushtet e përgjithshme te ambientit rrethuese			
<i>Shto sipas nevoje</i>			
OBJEKTET			
	Ne rregull	Jo ne rregull	Verejteje
Zyra			
Kabina			
Peshorja			
Plan-skica e Deponise			
Lista e telefonave për emergjenca			
Hapësira e parkimit			
Parku i gjelber			
Makineria			
Gjeneratorët			
Aparatet kunder zjarrit			
Ndihma e Pare			
Objektet përcjellëse			
<i>Shto sipas nevoje</i>			
INFRASTRUKTURA			
Rrugët e brendshme			
Bazeni, Lagunat /Ujrat e zeza			
Kanalet anësore/kullimet			
Shenjat udhëzues			
Shenjat kufizuese			
Shenjat e rrezikut			
<i>Shto sipas nevoje</i>			
DOKUMENTIMI /EVIDENCAT			
	Ne rregull	Jo ne rregull	Verejteje
Ditari			
Raporti I vizitoreve			
Raporti I Dërgesave			
Rregullat& Rregulloret& Udhezuesit			
Lista e nderrimit/orari i punes			
<i>Shto sipas nevoje</i>			

GJENDJA E DEPONISE, KUSHTET E TRAJTIMIT TE MBETURINES			
	Ne rregull	Jo ne rregull	Verejteje
Era/kundërmimi			
Ricirkulimi i ujerave te zeza			
Rrugët interne			
Zbrazjet /Zona e zbrazjes			
Shtrirja e mbeturinës			
Mbulimet Mbulimi ditor i mbeturinës			
Kompaktimi dhe ngjeshja			
Mbulimi i përkohshëm			
Prezenca e punëtorëve ne teren			
<i>Shto sipas nevoje</i>			
MAKINERIA NE DISPOZICION DHE GJENDJA E TYRE			
Bomagu			
Buldozeri			
Ekskavatori			
Kamioni			
Tankerët e naftës			
<i>Shto sipas nevoje</i>			
PENGESAT			
Moti			
Qentë endacak			
Ndërhyrja e personave te paautorizuar			
Mungesa e dheut			
<i>Shto sipas nevoje</i>			
VEPRIMET E NDERMARRA PARANDALUESE			
Spërkatja me ujë			
Dezinfektimi, Deratizimi dhe Dezinsektimi			
Gjelbërimi			
<i>Shto sipas nevoje</i>			
VEREJTJET E PERGJITHSHME APO KOMENTET			
DOREZUAR NGA (Emri dhe Mbiemri)		PRANUAR NGA (Emri dhe Mbiemri)	
Nënshkrimi _____		Nënshkrimi _____	
Data: _____		Data: _____	



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A
 Kosovo Landfill Management Company J.S.C
 Tel: 038 544 551, 544 552
 Adresa: Rr. Musine Kokollari -1 Dardani
 Prishtinë, Kosovë

ANEKSI IV Fatura per Pagese

R

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
 Prishtinë
 Rr. Musine Kokollari, 01, Prishtinë

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A
 Nr. i regjistrimit të biznesit: 70324870
 Nr. i TVSH-se: 2017
 Nr. fiskal: 606215570
 Nr. i fatures: 2

FATURA

Emri Adresa Qyteti Tel.	Klienti KRM Pastrimi William Walker p.n Prishtinë	Kosovë	Per muajin Shkurt 2017 Amviseri (nr01/07)	Data 3-Mar-17
----------------------------------	--	--------	---	------------------

Sasia	Pagesa për hudson e mbeturinave ne deponi	Çmimi	Sasia	GJITHSEJT
8233.18	KRM Pastrimi-amviseri	EUR 5.31	6.233.18	EUR 43.718.19
44.53	KRM Pastrimi-eshtra	EUR 50.00	44.53	EUR 2.226.50
0.00	KRM Pastrimi-xhama	EUR 50.00	0.00	EUR 0.00
0.00	KRM Pastrimi-asgjesim	EUR 50.00	0.00	EUR 0.00
682.70	KRM Pastrimi Podujeve-Amviseri	EUR 5.31	682.70	EUR 3.625.14
0.00	KRM Pastrimi Podujeve-eshtra	EUR 50.00	0.00	EUR 0.00
0.00	KRM Pastrimi Podujeve-xhama	EUR 50.00	0.00	EUR 0.00
0.00	KRM Pastrimi Podujeve-asgjesim	EUR 50.00	0.00	EUR 0.00
89.85	KRM Pastrimi Lipjan-Amviseri	EUR 5.31	89.85	EUR 477.10
0.00	KRM Pastrimi Lipjan-Eshtra	EUR 50.00	0.00	EUR 0.00
0.00	KRM Pastrimi Lipjan-xhama	EUR 50.00	0.00	EUR 0.00
0.00	KRM Pastrimi Lipjan-Asgjesim	EUR 50.00	0.00	EUR 0.00

Nëntotali: EUR 50.046.93

TVSH: EUR 4.003.75

Per pagese: EUR 54.050.68

Borxhi paraparak: € 1.573.250.45

Gjithsej Borxhi: EUR 1.627.301.13

Teksti

Emri i llogarisë: Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
 Nr. i llogarisë: 1110-206089-0001-81

Banka: ProCredit BANK

Vërejtje:
 Ju lutemi kur të kryeni pagesën përmes llogarisë bankare, cekoni emrin e kompanisë apo subjektit tuaj në përshkrimin e pagesës në formularin e transferit. Ju faleminderit për mirëkuptimin tuaj.

Ju lutemi të bëni pagesën 7 dite pas pranimit të fatures sepse në mungesë të pagesës së rregullit, do të bëni kufizime nga KMDK sh.a.

Deklarata e kompletimit:

Faturen e pergatiti: *[Signature]*
 Faturen e kontrolloi: *[Signature]*

Prishtinë, KE

Përmes kësaj, deklarojmë në emër të kompanisë së të gjitha të hollat e grumbulluara nga transportet privat janë grumbulluar sipas rregullorës dhe janë dorëzuar kompletë në KMDK SH.A.

Evidencat nga DS e Prishtinës - Mirash

Data	Muaji	Nr Serik	Koha	Kodi	Lloji mbeturinave	Regjistri i tabelave	Subjekti	Sasia ne KG
01.02.17	Shkurt	029008	23:56	200301	Mbet.e amviserise	01712FR	KRM Pastrimi Prishti	6,020.00
01.02.17	Shkurt	029007	23:53	200301	Mbet.e amviserise	01703FR	KRM Pastrimi Prishti	5,100.00
01.02.17	Shkurt	029006	23:50	200301	Mbet.e amviserise	01702FR	KRM Pastrimi Prishti	5,900.00
01.02.17	Shkurt	029005	23:47	200301	Mbet.e amviserise	01705FR	KRM Pastrimi Prishti	5,840.00
01.02.17	Shkurt	029004	23:43	200301	Mbet.e amviserise	01709FR	KRM Pastrimi Prishti	5,600.00
01.02.17	Shkurt	029003	23:37	200301	Mbet.e amviserise	01706FR	KRM Pastrimi Prishti	4,300.00
01.02.17	Shkurt	029002	23:20	200301	Mbet.e amviserise	01711FR	KRM Pastrimi Prishti	5,900.00
01.02.17	Shkurt	029001	18:50	200301	Mbet.e amviserise	01415AO	KRM Pastrimi Prishti	3,800.00
01.02.17	Shkurt	028999	18:33	200301	Mbet.e amviserise	01709FR	KRM Pastrimi Prishti	5,600.00
01.02.17	Shkurt	028998	18:30	200301	Mbet.e amviserise	01214BS	KRM Pastrimi Prishti	3,400.00
01.02.17	Shkurt	028997	17:15	200301	Mbet.e amviserise	01712FR	KRM Pastrimi Prishti	5,600.00
01.02.17	Shkurt	028996	16:35	200301	Mbet.e amviserise	01703FR	KRM Pastrimi Prishti	6,220.00
01.02.17	Shkurt	028995	16:22	200301	Mbet.e amviserise	01694BS	KRM Pastrimi Prishti	2,420.00
01.02.17	Shkurt	028991	15:15	200301	Mbet.e amviserise	01685BS	KRM Pastrimi Prishti	2,840.00
01.02.17	Shkurt	028989	15:00	200301	Mbet.e amviserise	01247BS	KRM Pastrimi Prishti	4,150.00
01.02.17	Shkurt	028987	14:50	200301	Mbet.e amviserise	01214BS	KRM Pastrimi Prishti	3,600.00
01.02.17	Shkurt	028986	14:48	200301	Mbet.e amviserise	01953IM	KRM Pastrimi Prishti	4,350.00
01.02.17	Shkurt	028985	14:46	200301	Mbet.e amviserise	01623AM	KRM Pastrimi Prishti	6,410.00
01.02.17	Shkurt	028984	14:43	200301	Mbet.e amviserise	01705FR	KRM Pastrimi Prishti	3,800.00
01.02.17	Shkurt	028983	14:32	200301	Mbet.e amviserise	01710FR	KRM Pastrimi Prishti	5,300.00
01.02.17	Shkurt	028982	14:37	200301	Mbet.e amviserise	01702FR	KRM Pastrimi Prishti	5,090.00
01.02.17	Shkurt	028981	14:35	200301	Mbet.e amviserise	01711FR	KRM Pastrimi Prishti	4,100.00
01.02.17	Shkurt	028980	14:27	200301	Mbet.e amviserise	01537GE	KRM Pastrimi Prishti	4,470.00
01.02.17	Shkurt	028979	14:25	200301	Mbet.e amviserise	IMT-01	KRM Pastrimi Prishti	1,900.00
01.02.17	Shkurt	028978	14:20	200301	Mbet.e amviserise	01521GN	KRM Pastrimi Prishti	7,500.00
01.02.17	Shkurt	028977	14:19	200301	Mbet.e amviserise	01708FR	KRM Pastrimi Prishti	3,330.00
01.02.17	Shkurt	028975	14:07	200301	Mbet.e amviserise	01816AD	KRM Pastrimi Prishti	6,210.00
01.02.17	Shkurt	028974	14:06	200301	Mbet.e amviserise	01706FR	KRM Pastrimi Prishti	4,130.00
01.02.17	Shkurt	028972	14:02	200301	Mbet.e amviserise	01534GE	KRM Pastrimi Prishti	2,450.00
01.02.17	Shkurt	028971	14:00	200301	Mbet.e amviserise	01415AO	KRM Pastrimi Prishti	2,860.00
01.02.17	Shkurt	028970	13:47	200301	Mbet.e amviserise	01712FR	KRM Pastrimi Prishti	2,880.00
01.02.17	Shkurt	028969	13:40	200301	Mbet.e amviserise	01709FR	KRM Pastrimi Prishti	5,150.00
01.02.17	Shkurt	028968	13:30	200301	Mbet.e amviserise	IMT116	KRM Pastrimi Prishti	5,470.00
01.02.17	Shkurt	028967	13:16	200301	Mbet.e amviserise	01769IS	KRM Pastrimi Prishti	2,000.00
01.02.17	Shkurt	028966	13:20	200301	Mbet.e amviserise	01370AO	KRM Pastrimi Prishti	4,140.00
01.02.17	Shkurt	028965	13:17	200301	Mbet.e amviserise	01701FR	KRM Pastrimi Prishti	4,400.00
01.02.17	Shkurt	028964	13:14	200301	Mbet.e amviserise	05854AN	KRM Pastrimi Prishti	2,800.00
01.02.17	Shkurt	028962	12:40	200301	Mbet.e amviserise	01534GE	KRM Pastrimi Prishti	7,000.00
01.02.17	Shkurt	028961	12:30	200301	Mbet.e amviserise	01921IO	KRM Pastrimi Prishti	3,650.00
01.02.17	Shkurt	028960	12:26	200301	Mbet.e amviserise	01415AO	KRM Pastrimi Prishti	1,050.00
01.02.17	Shkurt	028959	12:25	200301	Mbet.e amviserise	01302GN	KRM Pastrimi Prishti	3,700.00
01.02.17	Shkurt	028958	12:20	200301	Mbet.e amviserise	01685BS	KRM Pastrimi Prishti	7,450.00
01.02.17	Shkurt	028956	12:05	200301	Mbet.e amviserise	01994BM	KRM Pastrimi Prishti	3,940.00
01.02.17	Shkurt	028955	11:52	200301	Mbet.e amviserise	01921IO	KRM Pastrimi Prishti	5,140.00
01.02.17	Shkurt	028954	11:42	200301	Mbet.e amviserise	01953IM	KRM Pastrimi Prishti	540.00
01.02.17	Shkurt	028953	11:41	200301	Mbet.e amviserise	01705FR	KRM Pastrimi Prishti	5,430.00
01.02.17	Shkurt	028952	11:40	200301	Mbet.e amviserise	01247BS	KRM Pastrimi Prishti	5,300.00
01.02.17	Shkurt	028951	11:36	200301	Mbet.e amviserise	01710FR	KRM Pastrimi Prishti	4,180.00
01.02.17	Shkurt	028949	11:23	200301	Mbet.e amviserise	IMT116	KRM Pastrimi Prishti	5,100.00
01.02.17	Shkurt	028948	11:13	200301	Mbet.e amviserise	01708FR	KRM Pastrimi Prishti	3,000.00
01.02.17	Shkurt	028947	11:12	200301	Mbet.e amviserise	01694BS	KRM Pastrimi Prishti	4,860.00
01.02.17	Shkurt	028946	11:11	200301	Mbet.e amviserise	01703FR	KRM Pastrimi Prishti	3,340.00
01.02.17	Shkurt	028945	11:08	200301	Mbet.e amviserise	01769IS	KRM Pastrimi Prishti	5,150.00
01.02.17	Shkurt	028944	11:05	200301	Mbet.e amviserise	01921IO	KRM Pastrimi Prishti	5,730.00
01.02.17	Shkurt	028941	11:00	200301	Mbet.e amviserise	01706FR	KRM Pastrimi Prishti	600.00
01.02.17	Shkurt	028940	10:45	200301	Mbet.e amviserise	01701FR	KRM Pastrimi Prishti	4,540.00
01.02.17	Shkurt	028939	10:43	200301	Mbet.e amviserise	01143CN	KRM Pastrimi Prishti	4,100.00
01.02.17	Shkurt	028938	10:40	200301	Mbet.e amviserise	01702FR	KRM Pastrimi Prishti	5,040.00
01.02.17	Shkurt	028936	10:30	200301	Mbet.e amviserise	01711FR	KRM Pastrimi Prishti	5,940.00
01.02.17	Shkurt	028935	10:23	200301	Mbet.e amviserise	01623AM	KRM Pastrimi Prishti	4,750.00
01.02.17	Shkurt	028934	10:00	200301	Mbet.e amviserise	01415AO	KRM Pastrimi Prishti	4,740.00
01.02.17	Shkurt	028933	09:47	200301	Mbet.e amviserise	01534GE	KRM Pastrimi Prishti	3,350.00
01.02.17	Shkurt	028929	08:53	200301	Mbet.e amviserise	01994BM	KRM Pastrimi Prishti	3,540.00
								6,300.00